



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:292176

Datë: 07.04.2021

Numri i dokumentit: 01670998

P. nr. 323/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË D.P, gjyqtari Sejdi Blakaj me sekretaren juridike Fitore Bojku , në lëndën penale kundër të pandehurit K. G., sipas akuzës së PTH në Pejë PP/II.nr. 2122/19 të dt.210.4.2020, për shkak të veprës penale: lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par. 3 nën par. 3.1 lidhur me nenin 1 nën par. 1.3 të KPRK-se, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar , publik dhe me gojë, të mbajtur në praninë të pandehurit K. G. , të dëmtuarit Valdet Gega, dhe të prokurorit të shtetit Lumturije Hoxha me dt.07.4.2021 ka marrë dhe botërisht ka shpallë këtë :

A K T G J Y K I M

I pandehuri K. G. i lindur me dt..... në rruga “.....” nr. 2, ku edhe tani jeton, i biri i R.-it dhe nënës T. e gjinisë D., i njohur me dokument identifikues numër, ka të kryer shkollën mesme , me profesion instalues i ujit, i pa punë, i martuar baba i 3 fëmijëve , i gjendjes së dobët ekonomike, kinse i pa dënuar më parë nga gjykata, shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në liri.

ËSHTË FAJTOR :

Sepse :

Me datën 06.01.2019 rreth orës 14:00, në fsh., K., me mjet të rrezikshëm tjetrit i shkakton lëndim të rëndë trupor me dobësimin e përkohshëm të një pjese vitale të trupit dhe atë të dëmtuarit V. G.- të cilin e ka vëlla, në atë mënyrë që, ditën kritike, pas një fjalosje të atëçastshme që kishin ndërmjet vete, i pandehuri me një lopate ushtarake e godet të dëmtuarin në koke, me ç' rast të njëjtit i shkakton lëndime trupore.

-Me çka ka kryer veprën penale, lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par. 3 nën par. 3.1 lidhur me nenin 1 nën par. 1.3 të KPRK-se.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 38, 39, 40, 42, 44, dhe nenin 186 par. 3 nën par. 3.1 lidhur me nenin 1 nën par. 1.3 të KPRK-se, të pandehurin,

E G J Y K O N

Me dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 muajsh , të cilin dënim i pandehuri do ta vuaj pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë .

Dënimi me burg prej 6 muaj - me pëlqimin e të pandehurit i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej **300 € euro**, të cilën i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afat prej 3 muajsh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

I pandehuri për shkak të gjendjes së varfër ekonomike lirohet nga pagimi i shpenzimeve të procedurës penale

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë me dt.10.4.2020 kundër të pandehurit K. G. ,ka ngritë aktakuzë dhe PP.II.nr.2122/19, për shkak të veprës penale : lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par. 3 nën par. 3.1 lidhur me nenin 1 nën par. 1.3 te KPRK-se, duke i propozuar gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë të pandehurit ti shpallë fajtorë , ti dënoj sipas ligjit dhe ti obligoj në pagimin e shpenzimeve procedurale .

Në shqyrtimin fillestarë i pandehuri pasi që paraprakisht i është lexuar aktakuza , është njoftuar me të drejtat dhe detyrimet procedurale dhe pasojat e pranimit përkatësisht të mos pranimit të fajësisë- e ka pranuar fajësinë dhe ka manifestuar keqardhje për atë që i ka ndodhur. Këtë pranim fajësie gjyqtari – pasi që paraprakisht e ka marrë pëlqimin e prokurorit të shtetit dhe të dëmtuarit, i bindur se pranim fajësinë i pandehuri e ka bërë ashtu siç e parasheh ligji – vullnetarisht dhe pa u ndikuar nga askush dhe në asnjë mënyrë -e ka pranuar

Meqenëse i pandehuri e pranoj fajësinë gjyqtari kaloj në marrjen e vendimit lidhur me llojin dhe lartësinë e masës ndëshkuese , me ç rast i pati parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Rrethanë rënduese në rastin konkret gjyqtari nuk ka gjetur , kurse nga ato lehtësuese ka çmuar : pranimin e sinqertë të fajësisë që është rrethanë veçanërisht lehtësuese , pendimin e thellë për këtë gjë, qëndrimin korrekt në gjykatë, padënueshmërinë e mëparshme, faktin se i pandehuri është mbajtës i vetëm i familjes së tij dhe se askënd në familje nuk e ka të punësuar, e në veçanti faktin se edhe i dëmtuari – vëllai i tij ka deklaruar se me të pandehurin janë pajtuar dhe tani kanë raporte shumë të mira dhe jo vetëm kaq : i dëmtuari ka deklaruar se kundër të pandehurit nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk parashtron kërkesë për kompensimin e dëmit. , dhe kësisoj gjyqtari mendon se edhe me një vendim si në dispozitivin e aktgjykimit ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me neni 38 të KPK-së .

Vendimi mbi zbutjen e dënimit është bërë konform nenit 71 dhe 72 par 1 pika 1.5 të KPRK-së

Vendimi mbi shpenzimet e procedural është marrë konform nenit 453 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë konform nenit 365 të KPPRK-së u vendos si më lartë.

Nga Gjykata Themelore në Pejë D.P. datë. 04.7.2021.

Sekretarja juridike
Fitore Bojku

Gjyqtari
Sejdi Blakaj

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi lejohet
Ankesa në afat prej 15 ditësh nga
Dita e marrjes , Gjykatës të Apelit në Prishtinë
E përmes kësaj Gjykate .

Numri i lëndës: 2019:292176
Datë: 07.04.2021
Numri i dokumentit: 01670998